

## Radio Ngjallja zgjeroi harten e dëgjshmërisë



Me bekimin e Kryepiskopit Anastas, Radio Ngjallja zgjeroi harten e dëgjshmërisë së saj në FM edhe për qytetin e Pogradecit, Prrrenjasit, lugines së Shkumbinit, dhe zonave përreth. Tashmë besimtarët e krishterë orthodhoks, por dhe çdo dashamirës që banon dhe gjendet në keto zona mund të behet degjues i radios Ngjallja dhe programeve të saj të përditshme në frekuencën fm 90.6 mhz. Ky është investimi i dytë për qarkun e Korçës sipas licenses së AMA-s. Financimi për instalimin e sistemit transmetues në Çervenakë u krye nga OCMC me interesimin e drejtorit të saj At Martin Ritsi. Vlera e investimit është 10.000USD. Punimet, instalimi dhe mirëmbajtja në vazhdim e sistemit transmetues u krye nga TBS96 dhe që nga 12 Korriku 2022 sinjali i radios Ngjallja shtrihet në Pogradec, Prrrenjas dhe krahinat dhe fshatrat përreth. Dëgjim të këndshëm të Radios Ngjallja në këtë zonë të re transmetimi në FM 90.6.

[Radio "Ngjallja"](#)